



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M
Nr. 74, datë 30.11.2017

PËR
MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR DHE VLERËN E
DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA ZJARRI

Mbështetur në nenet 54 shkronja “dh”, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr. 8, datë 30.01.2017 “Për buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2017”, VKB nr. 51, datë 6.9.2017, Shkresa nr. 3950 prot, datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 30.11.2017, pas diskutimeve,

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër për vlersimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri për familjet e: z. Prek Doçaj; Mark Maci; Ndoc Stenaj, Dritan Stenaj, Bashkim Stenaj; Martin Ftoni; Ndue Kosteri, Arjan Kosteri, Kole Kosteri; Kole Shporja, Jetmir Shporja, Zef Shporja.
2. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 978,650 lekë (*nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë*) dhe orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 234,400 lekë (*dyqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind*), sipas preventivava për familjen e z.**Prek Docaj**.
3. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 1,367,544 lekë (*një milion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind dyzet e katër*), dhe orendi, mobilje

e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 238,600 lekë (*dyqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind*), sipas preventivava për familjen e z.**Mark Maci**.

4. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 2,563,582 lekë (*dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e dy*) dhe orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 626,360 lekë (*gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë*), sipas preventivava, për familjet e z. **Ndoc Stenaj, z.Dritan Stenaj dhe z.Bashkim Stenaj**.
5. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 1,296,072 lekë (*një milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e dy*) dhe orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 381,960 lekë (*treqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*), sipas preventivava për familjen e z.**Martin Ftoni**.
6. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 2,294,798 lekë (*dy milion e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë*) dhe orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 726,480 lekë (*shtatëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë*), sipas preventivava, për familjet e z. **Ndue Kosteri, z.Arjan Kosteri dhe z.Kole Kosteri**.
7. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 2,589,372 lekë (*dy milion e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy*) dhe orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 807,320 lekë (*tetëqind e shtatë mijë e njëzet*), sipas preventivava, për familjet e z.**Kole Shporja, z.Jetmir Shporja dhe z. Zef Shporja**.
8. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Punëve të Brendshme për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për familjet e z. Prek Docaj; Mark Maci; Ndoc Stenaj, Dritan Stenaj, Bashkim Stenaj; Martin Ftoni; Ndue Kosteri, Arjan Kosteri, Kole Kosteri; Kole Shporja, Jetmir Shporja, Zef Shporja, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, për shkak të pamundësisë së bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari e Bashkisë.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miraturar në datën 30.11.2017

Shpallur në datën 1.12.2017

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI QARKU SHKODËR

Pr. 18839 18.12.17 Sektori Juridik & Sektori i Perballimit te Emergjencave & Krizave

Nr1236prot

Shkoder me 15.12.2017

Lënda: Mbi vendimin nr.74 datë 30.11.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale te ligjit Nr.107/2016 dt 27.10.2016 "Për Prefektin", në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", neni 29, neni neni 64 germa c, ligjit Nr.8756,dt. 26.03.2001 "Per emergjencat civile", i ndryshuar, VKM NR.329 dt 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhezimit të Ministrave të Financave dhe të Ministrise se Brendshem Nr.263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmes shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore", VKB Nr.8 dt 30.01.2017 "Mbi miratimin e buxhetit te bashkise Shkoder 2017", shqyrtoi vendimin Nr.74 datë 30.11.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër: "Mbi miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor te familjeve te Z.Prek Docaj fshati Grude e Re Nja Rrethina, Z.Mark Maci fshati Ças NJA Velipoje, Z.Ndoc,Dritan dhe Bashkim Stenaj fshati Vuksanaj NJA Shale, Z.Martin Ftoni fshati Ndreaj NjA Shosh, Z.Ndue Kosteri, Arjan Kosteri dhe Kole Kosteri fshati Ndreaj Nja Shosh, Z.Kole Shporja, Jetmir Shporja dhe Zef Shporja fshati Ndreaj NJA Shosh, sipas vlerava të cituara në vkb".

Pas shqyrtimit konstatohet:

- Ne te gjitha rastet e preventivave ndertimore te familjareve është perfshire TVSH-ja 20%, jo në përputhje me udhezimet e Ministrise së Puneve të Brendshme (shkresa Nr.806 prot dt 8.02.2017, derguar juve me tonën Nr.221/1 dt.17.03.2017).
- Ne te gjitha rastet e preventivave ndertimore Zeri punimeve me nr.analize 516 Tuba plasmasi 0 100 mm eshte vendosur 313 leke dhe jo 263 leke (te sakesohet).
- Tek preventivat ndertimore te Zeri kepeje suvatim i brendshem i jeni refeuar çmimit 169 leke familjeve te z.Preke Docaj & z. Mark Maci, ndersa te familjet Shporja, Kosteri, Stenaj dhe Ftoni çmimi është 146 leke.(të procedohet për vlerën e saktë 146 lekë).
- Lidhur me vlerësimin e orendive dhe paisjeve elektro-shtëpiake çdo artikull duhet të jete i specifikuar tipi sipas listës te çmimeve,
- Sipas Sektorit te perballimit te krizave dhe emergjencave civile eshte konstatuar se të preventivat përkatëse te te demtuarve nuk jane vendosur datat e perpilimit te akteve per efekt te verifikimit te praktikave lidhur me afatet perkatese, referuar VKM Nr.329 dt. 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Përsa më sipër, Prefekti ju autorizon te procedoni për dhënien e ndihmës financiare familjeve të dëmtuara nga situata të tilla, duke konsideruar prioritet familjet e dëmtuara të cilat nuk mund të penalizohen nga pasaktësitë e stafit administrativ, me kusht që të bëhen të gjitha saktësimet sipas akteve ligjore në fuqi.

Me respekt,

P R E F E K T I

Çesk MILLJA

